- Subjektet me status fizik dhe juridik, si dhe SHBB-të duhet të paraqesin edhe dokumentin e regjistrimit në QKR;



c) Procesi i aplikimit për kompensim;
- Aplikimi fillon më 1 janar dhe përfundon më 30 tetor 2013;
- Aplikimi bëhet pranë zyrave të bujqësisë në rreth;
- Aplikimi (kërkesa) bëhet sipas formularit nr. 1;
- Zyra e bujqësisë në rreth, pas marrjes së kërkesave, plotëson formularin e pranimi të kërkesës (formulari nr. 2);

- Të gjitha kërkesat për rrethin regjistrohen në regjistrin e aplikimeve për rrethin dhe firmosen nga përgjegjësi i bujqësisë së rrethit dhe përgjegjësi i shërbimit këshillimor të qarkut (formulari nr. 3);

- Formularit të pranimi të kërkesës duhet t'i bashkëngjiten: fotokopje e kartës së identitetit, fatura e shitjes dhe kuponi tatimor, certifikata veterinare, vërtetim nga DRB-ja për numrin e koshereve të bletëve, vërtetim banke për numrin e llogarisë, dokumentin e regjistrimit në QKR (subjektet me status fizik dhe juridik, si dhe SHBB-të).

8. Plastmasë për sera

a) Përfitojnë kompensim të TVSH-së:

- Fermerët individualë;
- Subjektet me status fizik dhe juridik;
- Shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB);
- Subjektet me status juridik dhe fizik, si dhe SHBB përfitojnë vetëm në rastet kur merren me prodhim produktesh bujqësore dhe nuk përfitojnë ato që merren me tregtim imputesh bujqësore.

b) Kriteret e përfitimit të kompensimit

- Blerja e plastmasës të jenë e vërtetuar me faturë shitjeje të shoqëruar me kupon tatimor;
- Fermerët individualë kompensohen për sipërfaqet e serave deri në 3 ha për të gjitha llojet e kulturave bujqësore;

- Subjektet me status juridik, si dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor kompensohen për sipërfaqet e serave deri në 20 ha për të gjitha llojet e kulturave bujqësore;

- Sasia maksimale e plastmasës të përdorur do të jenë 3000 kg/ha (ose 12000 m²)

- Çmimi maksimal i blerjes do të jenë 500 lekë/kg;

- Përfutuesi duhet të paraqesë dokument për tokën bujqësore, e cila mund të jenë në pronësi, në përdorim ose me qira;

- Pranohet për dokument pronësie: certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie nga ZRPP/ akti i pronësisë së tokës sipas ligjit 7501/vërtetim pronësie nga komuna ose bashkia (sipas formatit bashkëngjitur);

- Subjektet me status fizik dhe juridik, si dhe SHBB-të duhet të paraqesin edhe dokumentin e regjistrimit në QKR.

c) Procesi i aplikimit për kompensim

- Aplikimi fillon më 1 janar dhe përfundon më 30 tetor 2013;
- Aplikimi bëhet pranë zyrave të bujqësisë në rreth;
- Aplikimi (kërkesa) bëhet sipas formularit nr. 1;
- Zyra e bujqësisë në rreth pas marrjes së kërkesave, plotëson formularin e pranimi të kërkesës (formulari nr. 2);

- të gjitha kërkesat për rrethin, regjistrohen në regjistrin e aplikimeve për rrethin dhe firmosen nga përgjegjësi i bujqësisë së rrethit dhe përgjegjësi i shërbimit këshillimor të qarkut (formulari nr. 3);

- Formularit të pranimi të kërkesës duhet t'i bashkëngjiten: fotokopje e kartës së identitetit, fatura e shitjes dhe kuponi tatimor, dokumenti i tokës bujqësore, vërtetim nga DRB-ja për sipërfaqen e serës, vërtetim banke për numrin e llogarisë, dokumentin e regjistrimit në QKR (subjektet me status fizik dhe juridik, si dhe SHBB-të).

III. Procedurat për kompensim

- Në çdo 10 ditë zyra e bujqësisë në rreth i përcjell kërkesat për kompensim, së bashku me dokumentacionin përkatës në drejtorinë rajonale të bujqësisë në qark (DRB);

- DRB-ja regjistron të gjitha kërkesat në regjistrin e dorëzimit për AZHBR-në formularin nr. 4;

- DRB-ja brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesave për aplikim i përcjell ato së bashku me dokumentacionin përkatës në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural në Ministrinë e Bujqësisë (AZHBR) (sipas formularit nr. 4);

- AZHBR-ja kontrollon të gjithë dokumentacionin për kompensim sipas kërkesave të këtij udhëzimi dhe bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit;

- E gjithë procedura në AZHBR, nga marrja e kërkesave nga DRB-të dhe deri në financimin e parave për përfituesin, nuk duhet të zgjasë më shumë se 30 ditë kalendarike.

**MINISTRI I BUJQËSISË USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli**

**MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode**

ANEKSI NR. 1

**TABELA E PËRDORIMIT TË PMB-ve SIPAS GRUP-KULTURAVE PËR EFEKT TË
KOMPENSIMIT TË TVSH-së**

Nr.	Grup-kulturat	Grupet e PMB-ve	Sasia lit ose kg/ha	Çmimi/kg ose lit
1	Perime fushe	Fungicide	15	4 000
		Insekticide	34.5	1 350
		Nematocide	15	4 000
		Herbicide	0.5	3 000
		Moluskicide	15	800
2	Perime sera	Fungicide	30	4 500
		Insekticide	32	2 500
		Nematocide	15	4 000
3	Patate	Fungicide	7.5	3 500
		Insekticide	0.75	25 000
		Nematocide	7.5	4 000
4	Të lashta	Herbicide	2	1 500
5	Misër	Herbicide	1.5	4 000
		Insekticide	18	1 300
6	Foragjere	Insekticide	2	4 000
7	Vresht	Fungicide	16	3 400
		Insekticide	4.5	4 000
		Herbicide	6	1 500
8	Pemë frutore	Insekticide	7.25	3 500
		Fungicide	6	5 000
		Herbicide	6	1 500
9	Ulli	Insekticide	4	2 500
		Fungicide	15	2 000
		Herbicide	6	1 500
10	Agrume	Insekticide	3.5	5 700
		Fungicide	15	2 000
		Herbicide	6	1 500



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMUNA/BASHKIA _____

Nr.Prot

_____, më / / 2013

VËRTETIM

Vërtetojmë se znj/z _____ ka në pronësi/përdorim _____ dynym (_____) tokë bujqësore.

Meqenëse nuk ka përfunduar shpërndarja e titujve të pronësisë i jepet ky vërtetim për efekt aplikimi për skemat e subvencionit në bujqësi.

Specialisti përgjegjës

Kryetari

FORMULARI NR.1

KËRKESË PËR KOMPENSIM

1	EMRI/ATËSIA/MBIEMRI ¹	
2	STATUSI I APLIKANTIT	
3	KARTA E IDENTITETIT	
4	KODI I FERMËS	
5	NIPT-I	
6	QARKU/RRETHI/KOM/BASHKIA/FSHATI	
7	NUMËR KONTAKTI TEL/CEL	

8. KOMPENSIM PËR BLERJE

Nr.	Emërtimi	Llojin që ke blerë	Sasinë
1	Plehra kimike		
2	Pesticide		
3	Fara/Fidanë		
4	Mushqerra/të imta racë e pastër		
5	Material për ndërzim		
6	Ushqim për blegtorinë		
7	Material për bletarinë		
8	Plasmas		

9. DEKLARIME NË LIDHJE ME APLIKIMIN

Toka (pronësi/përdorim/qera) _____ ha

Nr.kadastral/emërtimi i parceslës

¹ Emri, atësia, mbiemri të shënohen me germa kapitale.

10. Speciet e mbjella për të cilat kërkon kompensim

Emërtimi	Sipërfaqe (ha)

Vetëdeklarim

Deklaroj me përgjegjësinë time të plotë për vërtetësinë e të dhënave individuale dhe të fermës (1-10).

Data _____ 2013

Aplikanti

FORMULARI NR.2

FORMULARI PRANIMIT KËRKESËS

1	EMRI/ATËSIA/MBIEMRI	
2	STATUSI I APLIKANTIT	
3	QARKU/RRETHI/KOM/BASHKIA/FSHATI	

Kompensim për blerjen _____

Vlera e TVSH-së që kërkohet të kompensohet _____ lekë

Në dosjen e aplikantit ndodhet dokumentacioni i mëposhtëm:

Nr.	Dokumentacioni	Evidentimi		
		PO	JO	NK
1	Kërkesa (formulari 1)			
2	Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës			
3	Fatura me kuponin tatimor			
4	Vërtetim banke për numrin e llogarisë			
5	Dokumenti për statusin e aplikantit			
6	Dokumenti i pronësisë së tokës			
7	Dokumenti zooteknik të origjinës së racës			
8	Certifikata veterinare të kafshës/tufës			
9	Regjistri i fermës lopëve/deleve/dhive të matrikulluara			
10	Vërtetimin nga DRB-ja për aktivitetin			

Meqenëse dosja përmban gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kompensimin e _____ kërkesa pranohet.

Aplikanti

Përfaqësuesi i ZBRR-së

Data _____ 2013



REGJISTRI APLIKIMEVE PËR RRETHIN

Masa mbështetjes: “Kompensim TVSH”

Data dorëzimit _____ 2013

Nr.	Emri, mbiemri	Vendndodhja e aplikantit			Lloji blerjes	Vlera totale e mallit përfshirë TVSH (lekë)	Vlera e kompensimit TVSH (lekë)
		Rrethi	Komuna	Fshati			
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							
11							
12							
13							
14							
15							

Përgjegjësi i zyrës së bujqësisë

Përgj. shërbimit këshillimor në DRB-në e qarkut

REGJISTRI I DORËZIMIT NË AZHBR²

Masa e mbështetjes: “Kompensim TVSH”

Data dorëzimit _____ 2013

Nr.	Emri, mbiemri	Vendndodhja e aplikantit			Lloji blerjes	Vlera totale e mallit përfshirë TVSH (lekë)	Vlera e kompensimit TVSH (lekë)
		Rrethi	Komuna	Fshati			
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							
11							
12							
13							
14							
15	TOTALI QARKUT						

Përfaqësuesi i DRB
Përgj. shërbimit këshillimor

Drejtori DRB

Përfaqësuesi i AZHB-së

² Ky formular me këtë kokë të plotësohet në excel



URDHËR
Nr. 545, datë 11.6.2013

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”,

URDHËROJ:

1. Urdhrrat për dërgimin me shërbim të punonjësve të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) jashtë vendit, të lëshohen nga Drejtori Ekzekutiv i AIDA.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

3. Ngarkohet Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Florjon Mima

VENDIM
Nr. 25, datë 11.6.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 21.3.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 7 Akti, që i përket:

KËRKUES: Albert Noçka. Agim Kroj

SUBJEKT I INTERESUAR: Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtuashëm me Kushtetutën, i vendimeve: nr. 4428, datë 31.05.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 961, datë 4.5.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2012-1645, datë 6.7.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 132/1 dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 30, 76, 81/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 100/1, datë 26.8.2000, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), Tiranë, ka vendosur: *“Të njohë shtetasen Natalia Noçka pronare mbi pronën e përbërë nga një parcelë nr. 41, me sipërfaqe 1176 m², e ndodhur në Tiranë, në zonën mbrapa Stadiumit Qemal Stafa, me kufizimet: nga Lindja me rrugë, Perëndimi me parcelën 31, Jugu me parcelën 33 dhe Veriu me shëtitore....”*

2. Me kontratën e shitjes nr. 1991/433, datë 26.10.2000, shtetasja Natalia Noçka ia ka shitur pasurinë e mësipërme kërkuësve Agim Kroj dhe Albert Noçka, të cilët e kanë regjistruar edhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Tiranë.

3. Në vitin 2007, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit i është drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) Tiranë, për kundërshtimin e vendimit nr. 100/1 datë 26.8.2000 të ish-KKKP-së Tiranë, i dhënë në favor të subjektit të shpronësuar Natalia Noçka.

4. Me vendimin nr. 156, datë 8.8.2007, AKKP-ja Tiranë ka vendosur të konstatojë absolutisht të pavlefshëm vendimin nr. 100/1, datë 26.8.2000 të ish-KKKP-së Tiranë, me arsyetimin se trualli i kthyer në natyrë subjektit të interesuar nuk ishte i lirë, por i zënë me ndërtime publike dhe, për rrjedhojë, ish-pronari duhej të ishte kompensuar. Kundër vendimit të AKKP-së kërkuësit kanë paraqitur kërkesëpadi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt konstatimin të pavlefshëm të tij.

5. Me vendimin nr. 4428, datë 31.5.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadiës.

6. Me vendimin nr. 961, datë 4.5.2011, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

7. Me vendimin nr. 00-2012-1645, datë 6.7.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Albert Noçka dhe Agim Kroj.

II

8. **Kërkuësit, Albert Noçka dhe Agim Kroj**, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të tri shkallëve të gjykimit, duke pretenduar se ato janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Ndërkohë, në parashtimet e paraqitura në datën 6.3.2013, para zhvillimit të seancës plenare, kërkuësit kanë kërkuar vetëm shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim pranë asaj gjykate, pasi shkeljet e konstatuara janë brenda fushës së shqyrtimit nga Gjykata e Lartë dhe është e mundur që ajo ta shqyrtojë çështjen në themel duke i dhënë një zgjidhje përfundimtare, pa qenë i nevojshëm kthimi për rigjykim në gjykatat më të ulëta. Kërkuësit, në mënyrë të përmbledhur, parashtojnë këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

8.1 Është cenuar parimi i paanshmërisë në gjykim, pasi në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka marrë pjesë në trupin gjykues një gjyqtar (G.Z.), i cili më parë ka ushtruar funksionin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit dhe është pikërisht ai që ka firmosur kërkesën për vënien në lëvizje të procedimit administrativ që ka shfuqizuar vendimin nr. 100/1 të ish-KKKP-së Tiranë.

8.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, në disa drejtime:

8.2.1 Është cenuar parimi i të drejtave të fituara dhe pritshmërive të ligjshme që rrjedhin nga vendimi nr. 100/1 i ish-KKKP-së Tiranë, i cili krijon tek individit të njëjtat pritshmëri që krijon një vendim gjyqësor.

8.2.2 Gjykatat, nuk kanë respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 27, datë 26.5.2010, i cili ka shfuqizuar dispozitat ligjore që i njihnin drejtorit të AKKP-së kompetencën për të shfuqizuar vendimet e ish-KKKP-ve.



8.3 Edhe pse në rekurs janë parashtruar shkeljet e konstatuara në shkallët më të ulëta të gjykimit, të cilat janë tërësisht brenda fushës së shqyrtimit nga Gjykata e Lartë, kjo e fundit vendosi mospranimin e rekursit për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke mos korrigjuar mangësitë e gjykatave më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

9. Gjykata Kushtetuese (Gjykata), paraprakisht, thekson se i vlerëson pretendimet e kërkuarit në vështrim të standardeve kushtetuese që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor, dhe, konkretisht, në aspektin e detyrimit të Gjykatës së Lartë për respektimin e këtyre standardeve.

A. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim

10. Kërkuarit pretendojnë cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, për arsye se në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, ka marrë pjesë në trupin gjykues një gjyqtar (G.Z.), i cili më parë ka ushtruar funksionin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit dhe, në ushtrimin e këtij funksioni, ka vënë në lëvizje procedimin administrativ që ka cenuar të drejtat e kërkuarve.

11. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementët e rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 38, datë 15.10.2007; nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata, në jurisprudencë të vazhdueshme, ka theksuar rëndësinë e gjyimit nga një gjykatë e paanshme, me qëllim respektimin e të drejtave të palëve gjatë gjithë procesit. Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie (*shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 11, datë 5.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë roli i tij në mënyrë esenciale pasiv dhe *super partes* (*shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimet nr. 10, datë 2.4.2009; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 47, datë 7.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata vlerëson se edhe në rastin në shqyrtim paanshmëria duhet të vlerësohet në aspektin subjektiv dhe në atë objektiv. Për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarit G.Z., pra bindjes së brendshme të këtij gjyqtari për mënyrën e zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk rezulton që kërkuarit të kenë paraqitur ndonjë provë për të vërtetuar këtë pretendim, ndaj ajo prezumohet. Për sa i përket paanshmërisë objektive, duhet shqyrtuar nëse dyshimi i ngritur nga kërkuari është mjaftueshëm i provueshëm dhe ky përfundim varet nga rrethanat e çështjes konkrete. Lidhur me paanshmërinë objektive, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se fakti i thjeshtë që

gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor (*shih vendimin Gjonboçari kundër Shqipërisë, datë 31 mars 2005*).

15. Gjykata ka theksuar se paragjykimi eventual për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimet nr. 12, datë 13.4.2007; nr. 15, datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, pretendimi i kërkuësve për paanshmërinë e gjyqtarit lidhet me ushtrimin prej tij të dy funksioneve, brenda të njëjtit proces. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezulton se gjyqtari G.Z. ka ushtruar më parë detyrën e Avokatit të Shtetit dhe ka qenë përfaqësues i organit që ka vënë në lëvizje procesin administrativ pranë AKKP-së, Tiranë, për shfuqizimin e vendimit nr. 100/1, datë 26.8.2000 të ish-KKKP-së Tiranë. Kërkesa drejtuar AKKP-së Tiranë është firmosur nga Avokati i Shtetit (G.Z.) dhe, sipas kësaj kërke, ish-pronarit nuk mund t'i njëhej kthimi i pronës, pasi në atë moment ajo ka qenë e zënë për nevoja publike. Është pikërisht vendimi i marrë si rezultat i këtij procedimi administrativ që është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor.

16. Lidhur me shqyrtimin që kryhet nga kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, Gjykata ka vlerësuar se në këtë fazë të procesit verifikohet legjitimiteti i rekursuesit si dhe prania e kritereve ligjore për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, pra ai nuk është një shqyrtim në themel i shkaqeve të rekursit, çka është atribut i seancës gjyqësore. Megjithatë, Gjykata vlerëson se në ushtrimin e funksionit të Avokatit të Shtetit ky gjyqtar e ka manifestuar bindjen e tij brenda të njëjtit procedim dhe, si përfaqësues i interesave pasurore të shtetit, ka mbrojtur interesa të kundërta me ato të kërkuësit. Për pasojë, qëllimi dhe natyra e veprimeve që ai ka kryer gjatë procedimit administrativ janë të tilla që venë në dyshim paanshmërinë e tij.

17. Gjykata ka vlerësuar se kur ekzistojnë kushtet që justifikojnë një dyshim të përligjur për anshmëri gjatë gjykimit, detyra e çdo gjyqtari është t'i shmanget gjykimit, në mënyrë që të mos cenojë rregullsinë e procesit gjyqësor (*shih vendimin nr. 47, datë 7.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, pjesëmarrja e gjyqtarit G.Z. në trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që objektivisht kanë ekzistuar mundësitë për shmangien e tij nga gjykimi, ka krijuar një dyshim të justifikuar të kërkuësit, se vendimi i dhënë nuk ka qenë produkt i një procesi të paanshëm.

18. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuësve për cenimin e një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivist e paanshme, është i bazuar dhe duhet pranuar.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike

19. Kërkuësit pretendojnë cenimin e parimit të sigurisë juridike për disa arsye: është cenuar parimi i të drejtave të fituara dhe pritshmërive të ligjshme që rrjedhin nga vendimi nr. 100/1 i ish-KKKP-së Tiranë; gjykatat, edhe pse ishin në dijeni të vendimit të shpallur të Gjykatës Kushtetuese nr. 27, datë 26.5.2010, i cili ka shfuqizuar dispozitat ligjore që i njihnin drejtorit të AKKP-së kompetencën për të shfuqizuar vendimet e ish-KKKP-ve, nuk kanë pranuar kërkesën për pezullimin e procesit deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi; gjykatat nuk kanë mbajtur në konsideratë faktin e pasojave juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

20. Në lidhje me këtë pretendim Gjykata, gjatë votimit të çështjes, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj³, të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Në këto kushte, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", ky pretendim i kërkuësve refuzohet.

³ Për pranimin e pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike votuan pro gjyqtarët B. Dedja, S. Berberi, A. Thanza dhe F. Hoxha.

Gjyqtari V. Kristo votoi pro pranimit të kërkesës me argumentin se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2012-1645, datë 6.7.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha, Admir Thanza

VENDIM

Nr. 58, datë 29.5.2013

MBI SHTYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE TË BALANCIMIT

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.5.2013, pasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike për një ndryshim në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike,

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 33, datë 10.4.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ndryshohet si më poshtë:

Vendimi nr. 93, datë 16.7.2012, do t’i shtrijë efektet deri më 30 qershor 2013.

2. Ngarkohet Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 59, datë 3.6.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC
TRESKA” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HECET “TRESKA 2”, “TRESKA 3” DHE “TRESKA 4”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1, 3 dhe 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.6.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC Treska” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC Treska” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “HEC Treska” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Treska 2”, “Treska 3” dhe “Treska 4”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 60, datë 3.6.2013

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES TIP TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE MIDIS OST SHA DHE FURNIZUESVE TË KUALIFIKUAR**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës “V” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, pikës 4.13 germa “A” pika 3, pikës 7 germa “g” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.6.2013, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe marrëveshjen tip të transmetimit të energjisë elektrike, midis OST sh.a. dhe furnizuesve të kualifikuar,

konstatoi se:

- Subjektet e kësaj kontrate, OST sh.a. dhe çdo furnizues i kualifikuar, janë subjekte të licencuara nga ERE;

- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Modelin e Tregut të Energjisë miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338 datë 19.3.2008, Rregullat e Tregut të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar;

- Modeli i tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë natyrë kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Miratimin e draft marrëveshjes tip për shërbimin e transmetimit midis OST dhe furnizuesve të kualifikuar.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 61, datë 6.6.2013

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “TEODORI 2003” SHPK, PËR
LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SAJ SI KOLATERAL PRANË BANKAVE “BERZH” DHE
“SOCIETE GENERAL ALBANIA”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 10 pika 1 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës me seri PV10P “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.6.2013, pasi shqyrtoi kërkesën për lënie peng të aseteve si kolateral nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k., pranë Bankave “BERZH” dhe “Societe General Albania”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2, emri dhe adresa e plote e të licencuarit. (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korekte.)

- Neni 7, pikat 1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij. (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.)

- Neni 7, pikat 2, 3, 4 dhe 5 (ky informacion është plotësuar tërësisht.)

Është paraqitur lista e aseteve për t’u lënë peng si kolateral.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k., për lënie peng si kolateral të aseteve të saj pranë bankave “BERZH” dhe “Societe General Albania”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 62, datë 6.6.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HIDRO
ENERGY SOTIRA” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA HECET “SOTIRE”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1, 3 dhe 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjeshtë dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.6.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidro Energy Sotira” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hidro Energy Sotira” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjeshtë dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hidro Energy Sotira” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Sotire”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 63, datë 6.6.2013

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME SERI PV11P, NR. 128, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 58, DATË 22.6.2011 PËR SHOQËRINË “DN & NAT ENERGJI” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4 germat “a” dhe “b” të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1, germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.6.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “DN & NAT Energji” sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr. 128, seria PV11P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 58, datë 22.6.2011 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “DN & NAT Energji” sh.p.k., plotëson kërkesat ligjore siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës me nr. 128, seria PV11P, për prodhimin e energjisë elektrike të shoqërisë “DN & NAT s” sh.p.k., të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 58, datë 22.6.2011 nga hec “Kumbull Merkurth” me fuqi 630 kW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 21.6.2013
Doli nga shtypi më 21.6.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 36 lekë